



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRASNIJH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS	
Nr./Br./No	10
Nr. I faq/Br.str/No.pg	02
Data/Datum/Date	05 / 01 / 2022
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Punëve të Brendshme**  
**Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs**  
Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë - Odeljenje za upravljanje javnim  
službenicima- Department for the Management of Public Officials

Nr.1/2022  
Data 05.01.2022

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë,

Në pajtim me nenin 6 të Rregullores Nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues dhe Vendimin A.nr.887/2021, Nr.955 të datës 24.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil**

I. Anullohet procedura e rekrutimit me Nr.RN00007102 e publikuar me datë 11.06.2021 për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil – Ministria e Punëve të Brendshme.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me Vendimin A.nr.887/2021, Nr.955 të datës 24.12.2021: Shfuqizon Vendimin me nr. prot: 1412/12 të Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, Vendimin për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve të datës 15.10.2021 me nr. 5/2021 të Komisionit Shtetëror të Pranimin dhe anulon procedurat e rekrutimit për pozitën Drejtor Ekzekutiv në ARC/MPB të shpallur në konkursin e datës 11.06.2021 me numër reference RN00007102 nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Vendimi A.nr.887/2021, Nr.955 i datës 24.12.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e obligon Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në pajtim me Vendimin A.nr.887/2021, Nr.955 të datës 24.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, **anulon** procedurën e

rekrutimit me Nr.RN00007102 të publikuar më datë 11.06.2021 për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Duke u bazuar në atë që u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur ndaj këtij Vendimi, ka të drejtë të paraqes ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit të MPB-së;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së;
- KPMSHC-së
- Arkivit të MPB-së.



Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik  
Ministria e Punëve të Brendshme